EKSTRAKT I KUSHTEVE TË KONTRATES SË SIGURIMIT JETË PER HUA

Në zbatim të Ligjit Nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" Shoqëria e Sigurimit SiCRED sh.a. dhe Statutit e shoqërisë SiCRED sh.a. paraqesim si vijon ekstrakt të kushteve të Kontratës së Sigurimit.

Kontrata e Sigurimit Jetë për Hua është kontrata me anë të së cilës në rast të vërtetimit të ngjarjes së sigurimit përpara përfundimit të Policës së Sigurimit, Siguruesi detyrohet ti paguajë Përfituesit (Kreditorit) përfitimin për Sigurimin e Jetës deri në shumën e papaguar të huasë sipas parashikimeve të policës.

1.1 Përcaktime

a) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës për Sigurimin e Jetës për Hua, këtu e në vazhdim do të quhen **"*Kushtet e Sigurimit*"**.
b) Shoqëria e Sigurimit të Jetës "SiCRED" sh.a. do të quhet **"*Siguruesi*"**.
c) Individi, personi fizik ose personi juridik që përcaktohet si i tillë në Formular dhe që është përgjegjës për shlyerjen e huasë ndaj Kreditorit apo Përfituesit këtu e në vazhdim do të quhet **"*Debitori*".**
d) Individi që përcaktohet si i tillë në Formular Jeta e të cilit sigurohet sipas kësaj Kontrate, do të quhet **"*I siguruari*"** apo **"*të Siguruarit*"**.
e) Personi juridik (që këtu e me poshtë do të referohet edhe si Policëmbajtësi) që ka lëvruar huanë sipas një marrëveshje huaje dhe që përfiton të ardhurat që ofron kjo policë këtu e në vazhdim do të quhet **"*Përfituesi*"** apo **"*Kreditori*"**.
f) Dokumenti që vërteton lidhjen e Kontratës së Sigurimit, këtu e më poshtë do të quhet **"*Polica e Sigurimit*"**.
g) *Me* **"*Hua*"** do të kuptojmë huanë bankare apo ndonjë hua tjetër lëshuar nga ndonjë institucion kredidhënës.
h) Shuma e parave e fiksuar në Policën e Sigurimit, në ditën që lidhet Kontrata e Sigurimit këtu e në vazhdim do të quhet **"*Shuma e Sigurimit*"**.
i) Shuma e parave që i paguhet Siguruesit, për lidhjen e kontratës së sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet **"*Prim Sigurimi*"**.
j) Sasia e mjeteve monetare që nevojitet në çdo kohë për të paguar huanë, duke përjashtuar, çdo penalitet apo interes të akumuluar siç pasqyrohet në skedulin e caktuar të amortizimit kur lëvrohet huaja, si dhe çdo shpenzim tjetër që mund të ekzistojë deri në shlyerjen përfundimtare të huasë, këtu e në vazhdim do të quhet **"*Hua e Papaguar*"**.
k) Vdekja e personit të siguruar brenda periudhës së sigurimit, ndodhja e të cilës sjell detyrimin e Siguruesit për të paguar përfitimin sipas kushteve të sigurimit, këtu e në vazhdim do të quhet **"*Ngjarje e Sigurimit*"**.
l) Ngjarja e papritur dhe e paparashikuar që ndodh pa vullnetin e të siguruarit, e identifikueshme përsa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të siguruarin, këtu e në vazhdim do të quhet **"*Aksident*"**.
m) Humbja e Jetës si pasojë e shkaqeve natyrore, duke përjashtuar aksidentet, këtu e në vazhdim do të quhet **"*Vdekje Natyrore*"**.
n) **"*Rreziku i Vdekjes*"** do të nënkuptojë humbjen e jetës së të siguruarit për shkaqe aksidentale ose natyrore, brenda periudhës së vlefshmërisë së policës së sigurimit.
o) Me **"*Terrorizëm Bërthamor, Kimik ose Biologjik*"** do te nënkuptohet përdorimi i çdo arme apo pajisjeje bërthamore apo lëshimi, shkarkimi, shpërndarja, lirimi, apo rrjedhja e çdo agjenti kimik dhe/ ose biologjik te ngurte, të lënget apo gaz gjate periudhës se vlefshmërisë se polices, nga çdo person apo grup/grupe personash, pavarësisht nëse veprojnë të vetëm apo për llogari të ose në bashkëpunim me

çdo organizate/a apo qeveri, i bere për qëllime politike, fetare apo ideologjike apo për arsye dhe me qëllimin e influencimit te çdo qeverie dhe/ose për te frikësuar publikun apo ndonjë pjese te tij.

p) **"*Agjent Kimik*",** do të thotë çdo përbërës i cili, i përhapur në mënyrën e duhur, prodhon paaftësi, efekte vdekjeprurëse apo dëmtuese mbi njerëzit, kafshët, bimët apo materiale.
q) **"*Agjent Biologjik*",** do te thotë çdo mikroorganizëm/a patogjenik (që prodhon sëmundje) apo helme biologjike të prodhuara (përfshirë organizmat e modifikuar gjenetikisht apo helmet kimike sintetike) qe shkaktojnë sëmundje dhe/ose vdekje ne qeniet njerëzore, kafshët apo bimët.

1.2 Persona që nuk Sigurohen

a) Kanë të drejtë të sigurohen sipas kësaj kontrate të siguruarit që janë në kufijtë 18 deri në 65 vjeç.

Siguruesi nuk ofron sigurimin për:

a) Personat që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi ose sëmundje mendore si skicofrenia, format maniako – depresive të gjendjes paranoiake apo sindromat organike – cerebrale;
b) Personat që kërkojnë kujdes të përhershëm;
c) Personat që kanë mbushur moshën 65 vjeç;
d) Personat që nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç.

1.3 Rreziku i Vdekjes

Rreziku i vdekjes është i mbuluar pa asnjë kufizim territorial.

1.4 Përfitimi i Dëmshpërblimit

Në rast të vërtetimit të ngjarjes së sigurimit përpara përfundimit të Policës së Sigurimit, Siguruesi detyrohet t'i paguajë Përfituesit (Kreditorit) përfitimin për Sigurimin e Jetës deri në shumën e papaguar të huasë sipas parashikimeve të policës, por në çdo rast jo më shumë se shuma e siguruar.

1.5 Përjashtime

Për efekte të kësaj kontrate do të konsiderohen rreziqe të përjashtuara dhe Siguruesi nuk do të mbulojë humbjen e jetës të të Siguruarit në rast se humbja e jetës vjen si pasojë direkte apo indirekte e:

a) Çdo lloj defekti fizik apo mendor paraekzistues, sëmundjeve të njohura, të trajtuara apo të diagnostikuara përpara marrjes në sigurim, përveçse kur është deklaruar me shkrim nga i Siguruari dhe është pranuar nga Siguruesi.
b) Luftës, pushtimit, veprimeve të armikut të jashtëm, armiqësive/luftimeve (pavarësisht nëse është shpallur luftë ose jo), luftës civile, rebelimit, revolucionit, revoltës, kryengritjes, akteve terroriste te lidhura me terrorizmin bërthamor, kimik dhe biologjik;
c) Akte të qëllimshme të kryera nga përfituesi direkt kundër interesave të të siguruarit;
d) Reaksioneve bërthamore, rrezatimit bërthamor;
e) Pasojat e infektimit me virusin HIV, respektivisht SIDA, (Sindromi i Defiçiences Imunitare të Fituar);
f) Vetëvrasjes;
g) Pjesëmarrjes së të siguruarit në kryerjen e një krimi;
h) Udhëtimit të të Siguruarit me çdo mjet fluturimi, përveç se kur udhëton si pasagjer (dhe jo si anëtar i ekuipazhit), në një mjet fluturimi që është i autorizuar për transportin e pasagjerëve;
i) Sporteve të rrezikshme si sporteve motorike, zhytjes, alpinizmit të çdo lloji, hedhje e lirë nga lartësi me ose pa motor, parashutizmi, artet marciale, kanotazhi i çdo lloji, hedhjes nga lartësi të mëdha duke qenë i lidhur;
j) Pjesëmarrjes në gara shpejtësie të çdo lloji;

k) Përfshirjes së të Siguruarit në veprimtari të paligjshme apo kriminale, akte kriminale e keqëdashëse nga persona me të cilët i Siguruari ka konflikte të mëparshme, ose kur sigurimi kryhet në rrethana të paramenduara që favorizojnë pagesën e dëmit;
l) Humbjes së jetës së të siguruarit si pasojë e veprimeve të qëllimshme të trashëgimtarëve ligjore, apo ortakëve;
m) Vdekjen si pasojë e ndodhjes së të siguruarit nën influencën e alkoolit, përdorimit të drogës ose intoksikantëve të çdo lloji;
n) Në rast vdekjeje, përfituesi nuk do të paguhet në rast se kufoma nuk gjendet apo është e paidentifikueshme.

1.4 Paraqitja e Dokumentacionit për Trajtim Rast Dëmi

a) Për të gjitha pagesat që Siguruesi do të bëjë në kuadër të trajtimit të rastit të dëmit sipas kësaj Kontrate, duhet të dorëzohen paraprakisht dokumentet e mëposhtme:
   I. Njoftimin e rastit të Sigurimit;
   II. Polica origjinale e Sigurimit;
   III. Dokument i vlefshëm identifikimi;
   IV. Çertifikatë e vdekjes së të siguruarit;
   V. Skeda e vdekjes e firmosur nga mjeku ligjor;
   VI. Raporti mjeko - ligjor për datën e ndodhjes, rrethanat, dhe shkakun e vdekjes;
   VII. Epikrizë mjekësore e lëshuar nga mjeku kurues ku përshkruhet qartë data e shtrimit në spital, diagnoza klinike, mjekimet e kryera si dhe shkaku i vdekjes;
   VIII. Dokumentet që vërtetojnë shumën e dëmshpërblimit që Siguruesi detyrohet të paguajë (përfshirë shumën e huasë së papaguar);
   IX. Kopje e Kontratës së Kredisë me gjithë ndryshimet që mund ti jenë bërë nga Përfituesi si dhe një grafik të shlyerjeve të kredisë që ka realizuar Debitori;

b) Çdo dokument tjetër që mund të kërkohet nga Siguruesi.

1.5 Taksat dhe Tatimet

a) Taksat dhe Tatimet, nëse do të ekzistojnë do të jenë në ngarkim të të Siguruarit dhe Kreditorit.